PA1.nr.1003/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Shqipe Qerimi, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarve V.B. nga Mitrovica dhe S.M. nga fshati ..., Komuna e Zubin Potokut, për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 403 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore të Mitrovicë, PP.II.nr.947/2015 të datës 24 janar 2019, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.299/2015, të datës 16 shkurt 2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 21 shkurt 2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.299/2015, i datës 16 shkurt 2018, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e lartcekur, përkatësisht me aktgjykimin e ankimuar, të akuzuarën V.B. e ka shpallur fajtore për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 403 paragrafi 1 të KPRK, ndaj të njejtës është shqiptuar dënim me kusht, në atë mënyrë që është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse e akuzuara në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale, nga momenti kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Është detyruar e akuzuara V.B., që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej nga 30 € (tridhjetë Euro) dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej nga 10 € (dhjetë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Të akuzuarës V.B., i është bërë konfiskimi i përhershëm i automjetit të markës "Mercedes 190 E" me numër të shasisë ... dhe librezat e automjetit ... dhe ..., si sende të përdoruara dhe të përfituara si rezultat i kryerjes së veprës penale.

Është detyruar Agjencioni për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar të ndërmarrë veprimet përkatëse ligjore me sendet e konfiskuara, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

I akuzuari S.M., për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 403 paragrafi 1 të KPRK, është liruar nga akuza.

Shpenzimet e procedurës penale është vendosur që të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ta aprovojë ankesën në tërësi, ndërsa ta anulojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.M., avokati Kapllan Baruti, ka paraqitur përgjigje në ankesë me të cilën i ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ta refuzojë si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.1019/2019, të datës 11 tetor 2019, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar në pjesën liruese të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

- ankesa është e pabazuar.

Në ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, theksohet se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur të akuzuarën V.B. e ka shpallur fajtore për shkak të veprës penale për të cilën është akuzuar, ndërsa ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike kur të akuzuarin S.M. e ka liruar nga akuza, me arsyetimin se i njëjti nuk

e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka vlerësuar deklaratën e dëshmitarit I.I., zyrtar policor, i cili kishte thënë se nuk e njeh personin me emër S. dhe nuk e di që e ka intervistuar të njëjtin por atë ka mundur ta intervistojë ndonjë koleg i tij. Dëshmitari i lartcekur, në procedurën hetimore e kishte zhvilluar një hetim në bazë të asaj se në mesin e 400 librezave që janë regjistruar në Mitrovicën Veriore, të njëjtat të verifikohen. Të gjitha këto libreza janë dërguar për verifikim në Interpol ose në laborator dhe shumë prej tyre kanë rezultuar si të falsifikuara dhe në mesin e tyre edhe libreza në emër të të akuzuarit S.M., e cila librezë më pastaj ishte regjistruar në emër të të akuzuarës V.B.. Libreza në emër të S.M.it nuk ka qenë kurrë e regjistruar, por është regjistruar kinse pa targa KM dhe arsyeja se është bërë kjo është se në bazë të udhëzimit administrativ 24/2011, MPB i ka liruar të gjitha automjetet të cilat janë të regjistruara me targa të ish Jugosllavisë që të regjistrohen në Kosovë pa paguar obligimet doganore. Libreza CP fillimisht është falsifikuar në emër të S.M.it kinse ka pasur targa ... dhe me këtë librezë e kanë bërë një kontratë të shitblerjes në mes të të akuzuarit S., si shitës dhe të akuzuarës Vjollca, si blerëse dhe me këtë kontrate dhe librezë janë drejtuar QRA në Mitrovicën Veriore, ku edhe kanë arritur që ta regjistrojnë automjetin me targa ... në emër të V.B.t. Në anën tjetër, i akuzuari S.M. e kishte mohuar aktakuzën me arsyetimin se i njëjti të ketë bërë shitblerjen e automjetit sipas kontratës së lartcekur, e cila më vonë është përdorur në QRA për regjistrimin e automjetit në fjalë, edhe pse nga ekspertiza grafologjike është konstatuar se i akuzuari S.M. nuk është personi i cili e ka nënshkruar kontratën e shitblerjes, edhe pse në shkresat e lëndës gjendet një kopje e letërnjoftimit. Prokuroria Themelore në Mitrovicë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, pasi që me provat që janë administruar në shqyrtim gjyqësor, rezulton se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet qenësore të veprës penale për të cilën i njëjti është akuzuar. Andaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Prokuroria Themelore në Mitrovicë i ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës si më lart.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë janë të pabazuara. Kjo për faktin se gjendja faktike në këtë çështje juridike penale është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ngase me provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari S.M. të këtë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë kishte administruar disa prova, ku ishte dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit z.I.I., zyrtar policor në Njësinë e Hetimeve të Autokrimeve në Mitrovicë, pastaj janë administruar provat materiale si: ekspertiza e Agjencionit të Forenzikës së Kosovës, me numër AKF/2014-0622/2014-504 e datës 21 prill 2014, shkresa nga ILECU me numër FW:AT-2014-102 e datës 6 mars 2014, libreza e qarkullimit ..., libreza e qarkullimit ..., kontrata mbi shitblerjen e automjetit e datës 24 shkurt 2012, lista e gjërave të konfiskuara, si dhe janë vlerësuar deklaratat e të akuzuarve V.B. dhe S.M.. Pas administrimit, vlerësimit dhe analizimit të të gjitha këtyre provave, gjykata e shkallës së parë e kishte liruar nga akuza

të akuzuarin S.M., me arsyetimin se nuk është provuar se i njëjti e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Kjo për faktin se nga provat e administruara nuk ka rezultuar se i akuzuari S.M. së bashku me të akuzuarën V.B. të ketë vënë në lajthim organin kompetent që me një dokument publik ta vërtetojë një çështje të pavërtetë, të paraparë për të shërbyer si provë në një çështje ligjore, ashtu që të akuzuarit në bashkëveprim të kenë shkuar në QRA në Mitrovicë dhe me librezën e qarkullimit të falsifikuar CP08681895, e cila ishte librezë serbe dhe me këtë arrijnë ta regjistrojnë dhe legalizojnë dokumentin e falsifikuar për automjetin e tipit "Mercedes 190E", me numër të shasisë ... dhe i marrin targat e ..., si dhe librezën e qarkullimit ... në emër të V.B.t, e që është vërtetuar nga laboratori i kriminalistikës që libreza e automjetit është e falsifikuar. Siç rezulton nga aktgjykimi i ankimuar, i akuzuari S.M. e kishte mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën ishte akuzuar, duke shtuar se nuk e njeh të akuzuarën V.B. të cilën për herë të parë e kishte parë gjatë seancave gjyqësore në gjykatë, e cila deklaratë e tij është në përputhje edhe me deklaratën e të akuzuarës V.B. e cila kishte deklaruar se nuk e njeh të akuzuarin S. dhe se babai i saj, automjetin në fjalë e kishte pasur në posedim qe 12 vjet. Në anën tjetër, as nga dëshmia e dëshmitarit I.I. nuk ka mundur të vërtetohet se i akuzuari S.M. të ketë ndërmarrë ndonjë veprim që është pjesë përbërëse e elementeve të veprës penale, ngase dëshmitari në fjalë, nuk ka mundur të vërtetojë nëse i akuzuari të ketë shkuar në QRA në Mitrovicë për ta regjistruar automjetin në fjalë. Kurse, nga ekspertiza grafologjike e Agjencionit Kosovar të Forenzikës është konstatuar se i akuzuari S.M., nuk është personi i cili ka nënshkruar kontratën e shitblerjes së automjetit në fjalë, e cila kontratë figuron se është lidhur në mes të të akuzuarit S., si shitës dhe të akuzuarës Vjollca, si blerëse. Duke u bazuar në të gjitha këto prova të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë e kishte liruar nga akuza të akuzuarin S.M. me arsyetimin se nuk është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, me të cilin vendim pajtohet në tërësi edhe kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës i cili i vlerëson si të drejta përfundimet e gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me faktet vendimtare në këtë çështje penale, ngase me provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor nuk ka mundur të provohet përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se i akuzuari S.M. ta këtë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur të akuzuarin S.M. e ka liruar nga akuza dhe në rastin konkret nuk kemi të bëjmë as me shkelje të ligjit penal, kështu që edhe pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë nuk qëndrojnë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Bashkëpunëtorja profesionale,	Anëtarët e kolegjit:	Kryetar i kolegjit,
Kimete Veseli	Afrim Shala	Gani Zabeli
_____	_____	_____
	Shqipe Qerimi	
	_____	